



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 16, Datë 23.01.2020

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “DIEZELA” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “LJUSA” ME KAPACITET
TË INSTALUAR 1980 KW**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, gërma ”a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5 pika 1, gërma “a” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 23.01.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes nr. 67/2 Prot., datë 12.07.2019; Relacionin Plotësues nr. 89/3 Prot., datë 11.09.2019 dhe Relacionin nr. 19/3 Prot., datë 18.01.2020, “Për licencimin e shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga Hec “Ljusa” me kapacitet të instaluar 1980 MW”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me Vendimin nr. 82, datë 31.05.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Ljusa” me kapacitet të instaluar 1980 kW.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 32/26 prot., datë 03.06.2019, ka kryer njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, në datën 17.06.2019, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “DIEZELA” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE me shkresën nr. 316/1 Prot., datë 05.06.2019, ka përcjellë pranë shoqërisë njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës dhe kërkesën për plotësim të dokumentacionit të munguar, i cili konsistonte si më poshtë:

- **Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor** neni 9, pika 2: **gërma “d”** (vertetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë); **gërma “g”** (dokumenta që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shit – blerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti). Në lidhje me këtë kërkesë të rregullores, duke qenë se afati i kontratës së qirasë ishte një vit pa të drejtë rinovimi, i’u kërkuar shoqërisë të bëjë me dije ERE-n nëse ka patur më tej komunikime për zgjatjen e afatit të kësaj kontrate, me qëllim mbulimin e periudhës së licencimit.
 - **Dokumentacioni teknik për HEC**, neni 9, pika 4.1.1. Të dhëna teknike për Hec, neni 9, pika 4.1.2. Të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin, neni 9, pika 4.1.4. Dokumentacioni tekniko-ekonomik, **gërma “a”**. (Studimi i fizibilitetit), neni 9, pika 4.1.5. Leje nga institucione të tjera, **gërma “b”** (Leja e përdorimit të ujit nr. 152 Prot., datë 08.01.2019, miratuar me Vendimin e Këshillit të Basenit Ujor Mat nr. 4, datë 22.12.2017, *“Për miratimin e lejes së përdorimit të ujit për prodhim të energjisë elektirke, nëpërmjet ndërtimit të HEC “Ljusa”, nga subjekti “DIEZELA” sh.p.k, Lumi Mat, Përroi i Zallit të madh, degë e Përroit të Ljusës, degë e Lumit Mat në fshatin Gjalisht, Bashkia Mat, Qarku Dibër”*, është e vlefshme për periudhën 22.12.2017 - 22.12.2022.
- Shoqëria “DIEZELA” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 316/2 prot., datë 21.06.2019, ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar më sipër.
 - ERE në datën 05.07.2019, zhvilloi një seancë dëgjimore me përfaqësues të shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k për të sqaruar më tej situatën e pronësisë.
 - Shoqëria “DIEZELA” sh.p.k ka depozituar në ERE Urdhërin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, me nr. 289, datë 24.08.2018, “Për heqjen nga fondi pyjor dhe kullor publik të sipërfaqjes prej 0.13 ha në ekonominë pyjore “Balgjaj” dhe “Derjan 1”, të Bashkisë Mat, për ndërtimin e HEC “Ljusa” nga shoqëria “DIEZELA” sh.p.k.” Sipas këtij urdhëri, kjo sipërfaqe do të përdoret si shesh ndërtimi për “Hec Ljusa”. Shoqëria ka depozituar edhe kontratën e qirasë nr. 1460 Prot., datë 05.06.2018, “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor kullor publik shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k për ndërtimin e HEC “LJUSA”, të lidhur midis Bashkisë Mat dhe shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k. Objekti i kësaj kontrate konsiston në dhënien me qira të fondit pyjor – kullor për ndërtimin e HEC “Ljusa”. Kjo kontratë mban një afat një vjeçar që fillon nga e nesërmja e datës së nënshkrimit të saj.
 - Shoqëria “DIEZELA” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE nr. 316/2 Prot., datë 21.06.2019, ka depozituar “Amendim për shtesë afati” nr. 1575 Prot., datë 12.06.2019 me objekt: “Zgjatje e afatit të kontratës me Bashkinë Mat për Përdorimin e Fondit/Pyjor Kullor Publik, për ndërtimin e HEC Ljusa.” Nëpërmjet këtij amendimi, afati i kontratës shtyhet me 1 vit duke filluar nga data e përfundimit të kontratës bazë e cila mbetet e pandryshuar, përveç afatit të shtyrë edhe me një vit tjetër (kontrata bazë ka përfunduar 06.06.2019).

- Shoqëria “DIEZELA” sh.p.k në cilësinë e Mbajtësit të Miratimit Përfundimtar me nr. 2413/6 prot., datë 15.12.2017 dhe në zbatim të VKM nr. 822, datë 07.10.2015 *“Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”*, i ndryshuar, ka lidhur me MIE Kontratën me nr. 15 Rep. dhe nr. 8 Kol. datë 10.01.2018, *“Për Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e hidrocentralit “Ljusa” me kapacitet të instaluar 1980 kW, në Përroin e zallit të madh, degë e përroit të Lusës, kjo e fundit degë fundore e krahut të djathtë të lumit Mat, Bashkia Mat, Qarku Dibër”*.
- Në mbledhjen e datës 22.07.2019, u relatua Relacioni nr. 67/2 Prot., datë 12.07.2019, *“Për licencimin e shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ljusa” me kapacitet të instaluar 1980 kW”*.
 - Nga ana e Bordit të ERE u shty ky miratim, pasi lindi nevoja për sqarime në lidhje me paraqitjen në ERE të Urdhërave të MIE për pezullimin dhe rifillimin e punimeve, ecurinë e procesit të pajisjes me Leje Ndërtimi, deklarimin e bërë për kalimin në pronësi të shoqërisë DIEZELA sh.p.k, të sipërfaqjes së përcaktuar në kontratën e qirasë pas përfundimit të punimeve dhe gjobës nga tatimet, afatet e Lejes Mjedisore dhe asaj të përdorimit të Ujit.
 - ERE i është drejtuar shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k. me shkresat nr. 316/5 Prot., datë 08.08.2019 dhe nr. 316/6 Prot., datë 30.08.2019, duke i kërkuar të bëjë plotësime dhe të japë sqarime në lidhje me sa më sipër.
 - Në vijim shoqëria “DIEZELA” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 316/7 Prot., datë 02.09.2019, ka paraqitur në ERE shpjegimet dhe plotësimet përkatëse.
 - Shoqëria “DIEZELA” sh.p.k. ka dërguar në ERE Urdhërin nr. 48, datë 30.01.2019 të Ministres së Infstrukturës dhe Energjisë, *“Për verifikimin e zbatimit të kushteve të kontratave koncesionare, objekt i VKM-së nr. 822, datë 07.10.2015, nga burimet hidrike të energjisë.”*, me anë të të cilit urdhërohet fillimi i procesit të verifikimit të zbatimit me përpikmëri të projektit dhe respektimit të kushteve mjedisore, kapacitetit prodhues dhe çdo angazhimi tjetër kontraktor.
 - Shoqëria “DIEZELA” sh.p.k. ka depozituar në ERE kopje të konfirmimit për kryerjen e aplikimit online për pajisje me Leje Ndërtimi. Sa më sipër, rezulton se pa u pajisur me Leje ndërtimi kjo e fundit nuk mund të përfundojë regjistrimi i sipërfaqjes së godinës së centralit, duke qenë se ky dokument i është kërkuar nga Z.R.P.P.
 - Shoqëria e ka dokumentuar me Vërtetimin e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë me nr. T01336665, datë 31.08.2019, që ka përcjellë bashkëlidhur shkresës nr. 316/7 Prot., datë 02.09.2019, se nuk ka detyrime të sigurimeve shoqërore pa paguar.
 - Shoqëria ka paraqitur në ERE *“Leje për përdorim të Burimit Ujor”* nr. 152 Prot., datë 08.01.2018, miratuar me Vendimin nr. 4, datë 22.12.2017 *“Për miratimin e lejes së përdorimit të ujit për prodhim të energjisë elektrike, nëpërmjet ndërtimit të HEC “Ljusa”, nga shoqëria “DIEZELA” sh.p.k., Lumi Mat, Përroi i Zallit të madh, degë e Përroit të*

Ljusës, degë e Lumit Mat në fshatin Gjalisht, Bashkia Mat, Qarku Dibër.” Kjo leje është e vlefshme për periudhën 22.12.2017 - 22.12.2022.

- Shoqëria ka përcjellë në ERE, Vendim për VNM Paraprake me nr. 1020 Prot, datë 26.04.2017 dhe nr. 17 vendimi me numër identifikimi 280. Ky vendim është lëshuar për të zhvilluar projektin “*Shfrytëzim i kapaciteteve hidroenergjitike të përroit të Ljusës*”, nga shoqëria “DIEZELA” sh.p.k. me vendodhje të HEC “Ljusa” në Dibër, me kapacitet të instaluar 1,980 kW. Në këtë vendim përcaktohet se projekti nuk duhet ti nënshtrohet VNM-së së thelluar. *Ky vendim është i vlefshëm vetëm pasi shoqëria licencohet nga institucionet përkatëse. Mosfillimi i veprimtarisë brenda një periudhë 2 vjeçare sjell pasojë pavlefshmërinë e vendimit për ushtrimin e tij. Ky vendim është i vlefshëm pasi subjekti të pajiset me Leje Shfrytëzimi ujqor nga KBU përkatëse.*”
- Shoqëria është pajisur me Lejen e Ujit, me vendimin nr 4 datë 22.12.2017 të Këshillit Kombëtar të Ujit. Duke marrë në konsideratë edhe faktin se shoqëria nuk ka filluar veprimtarinë për të cilën lëshohet leja/nuk ka filluar ndërtimin e veprës, “Leja Mjedisore” nr. 1020 Prot., datë 26.04.2017 dhe nr.17 vendimi me numër identifikimi 280, rezulton e përfunduar, në datën 22.12.2019.
- Aplikimi i shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “*Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*” si më poshtë:
 - **Formati i aplikimit** (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar;
 - **Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor** (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”) është plotësuar;
 - **Dokumentacioni financiar dhe fiskal** (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar;
 - **Dokumentacioni teknik** (neni 9, pika 4.1.1, pika 4.1.2, pika 4.1.3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”; pika 4.1.4 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 4.1.5 gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar;
 - **Leje nga institucionet e tjera**, (neni 9, pika 4.1.5, gërmat “a”, “b”), është plotësuar;**Dokumentacion i plotësuar pjesërisht rezulton:**
 - **Leje nga institucionet e tjera**, (neni 9, pika 4.1.5, gërma “c”).

Kontrata e lidhur midis METE dhe subjekti “DIEZELA” sh.p.k, ka një afat 49 vjeçar, por ERE në zbatim të nenit 38 të Ligjit “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”, i ndryshuar dhe nenit 5 të “*Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Liçensave në Sektorin e Energjisë Elektrike*”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “DIEZELA” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ljusa” me kapacitet të instaluar 1980 kW, për një afat 30 vjeçar, me

kusht që, përpara fillimit të operimit të HEC-it “Ljusa”, shoqëria të përcjellë në ERE Lejen Mjedisore për qëllime të ushtrimit të aktivitetit të licencuar.

2. Shoqëria “DIEZELA” sh.p.k. të depozitojë në ERE lejen e ujit të rinovuar përpara përfundimit të saj në datën 22.12.2022.
3. Shoqëria “DIEZELA” sh.p.k të depozitojë në ERE çdo dokument/leje që i nënshtrohet procedurës së rinovimit, nga institucionet që i lëshojnë ato, jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të afatit të parashikuar në këto dokumenta/leje.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI